



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 137-Prill 2015 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Tribuna profesionale për
EHKK dhe masat parandaluese

Konferenca "Ethet hemorragjike
krime-kongo në Kosovë"



Pamje gjatë pastrimit të ambientit



Përmbajtja:

Shënohet Dita e Ambientit në Malishevë	3
Hapet edhe një fabrikë për prodhimin e mobiljeve	4
Kryetari Begaj, fton investitorët turq të investojnë në Malishevë	5
Krasniqi: Malisheva më e mira në shpenzimin e buxhetit për vitin 2014.....	6
Krasniqi: Malisheva më e mira në shpenzimin e buxhetit për vitin 2014.....	6
Nexhmedin Spahiu promovon “foshnjërinë e kombit kosovar” në Malishevë.....	7
Mbi 400 mijë euro për rehabilitimin e ujësjellësve.....	8
Për mungesë kuorumi u ndërpre mbledhja e jashtëzakonshme	9
15 fermerë përfitojnë përkrahjen e komunës për ndërtimin e serave.....	10
Kryetarët e fshatrave të Malishevës, kërkojnë zyrtarisht kthimin e Malishevës me regjionin e Prizrenit	11
U mbajt dëgjimi i parë publik për tri rregullore.....	12
Përfundoi asfaltimi i rrugës në fshatin Burim.....	13
Ka filluar pastrimi i ambientit.....	14
KPF mbajti mbledhjen e radhës	15
U mbajt tribuna profesionale për EHKK dhe masat parandaluese.....	16
U mbajt testi ndërkombëtar PISA me nxënësit nga Malisheva.....	17
Po vazhdon realizimi i disa projekteve	18
Përmirësohen kushtet e punës për shërbimin zjarrfikësve dhe shpëtimit në Malishevë	19
Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e shoqatës QAD.....	20
Ekipe të shpëtimit, shpëtojnë banorët e qendrës së banimit social nga zjarri	21
Ekipe të shpëtimit, shpëtojnë banorët e qendrës së banimit social nga zjarri	21
U mbajt konferenca “Ethet hemorragjike krime-kongo në Kosovë”	22
Florian Begaj dhe Adelina Javori, fitues të krosit pranveror	24
Florian Begaj dhe Adelina Javori, fitues të krosit pranveror	24
Kryetari Begaj në përkrahje të familjarëve të të pagjeturve	25
Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve.....	26
Historiani Imeraj, promovoi projektin mbi gjenocidin	27

Një kompani holandeze, interesohet për të investuar në Malishevë	27
Kryetari Begaj, paraqiti para Kuvendit të Komunës, raportin e punës për vitin 2014.....	28

Shënohet Dita e Ambientit në Malishevë

Malishevë, 1 prill



Me një aktivitet simbolik, sot në Malishevë, është shënuar Dita e Ambientit, përmes pastrimit të një pjese të qytetit dhe mbjelljes së drunjve në parkun e qytetit dhe në hapësirat tjera të gjelbëruara, edhe pse kushtet atmosferike, përkatësisht reshjet e shiut, kanë ndikuar në zhvillimin e plotë të aktivitetit.

Në aksionin e sotëm të pastrimit të ambientit përveç një pjese të administratës komunale, morën pjesë edhe nxënësit e shkollave të mesme

dhe punëtorët e njësisë së “Eko regjionit” në Malishevë.

Përndryshe, muaji prill, edhe këtë vit, do të jetë muaj i ambientit dhe është prej prioriteteve të Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ku do të bëhet largimi i mbeturinave në deponitë ilegale, të krijuara nga qytetarët, në afërsi të vendbanimeve. Pastrimi i ambientit, është edhe njëra prej temave kryesore të kryetarit, në takimet e drejtpërdrejta me qytetarët, ku kryetari Begaj, kërkon nga qytetarët, që ta ruajmë ambientin ku jetojmë.

Hapet edhe një fabrikë për prodhimin e mobiljeve

Kijevë, 2 prill



Kompania e cila merret me mobilje, “Delfina”, edhe solemnisht ka hapur sot fabrikën për prodhimin e mobiljeve. Në ceremoninë e hapjes së fabrikës, mori pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, Kryesuesi i KK-së z.Aziz Thaçi dhe një pjesë e qeverisë komunale, dhe me këtë rast e kanë uruar kompaninë për këtë arritje dhe këtë investim, i cili ndikon në punësimin e të rinjve.

Sipas nënkryetarit Mazreku, përveç lehtësirave që komuna jonë ju ka krijuar përmes heqjes së taksave, në të ardhmen do ti përkrah edhe në forma tjera, bizneset prodhuese, të cilat arrijnë të rrisin numrin e të punësuarve dhe rrjedhimisht zbutin papunësinë.


Kjo fabrikë ka punësuar dymbëdhjetë persona, ndërsa pritet të rritet numri i punëtorëve në mbi tridhjetë, me çka, përveç përfitimit personal, do të arrij të punësoj edhe persona të tjerë, duke e zbutur papunësinë. Investimi i kompanisë “Delfina”, kap një shumë të përgjithshme, prej 1.1 milion euro dhe është investim tërësisht nga kapitali personal

Edhe pse situata ekonomike në vend nuk konsiderohet shumë e favorshme, disa nga bizneset e suksesshme të komunës sonë, arrijnë jo vetëm të mbijetojnë, por edhe rrisin kapacitetet e tyre. Njëri prej tyre është edhe biznesi “Delfina”, me pronar Fadil Mazrekun, i cili tashmë e ka hapur këtë fabrikë, e cila pritet të ketë edhe një numër të konsiderueshëm të të punësuarve.



Kryetari Begaj, fton investitorët turq të investojnë në Malishevë

Antalya, 3 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, këto ditë po qëndron në Turqi, në kuadër të një vizite zyrtare të organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, së bashku me disa kryetar të komunave tjera, dhe me këtë rast, e ka shfrytëzuar këtë vizitë, për tu takuar me shumë personalitete nga jeta e politikës dhe biznesit në Turqi, si dhe i ka ftuar investitorët turq, të investojnë në Malishevë.

Në kuadër të kësaj vizite të organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, delegacioni nga Kosova kanë vizituar një panair i cili është duke u mbajtur në qytetin Antalya, dhe në ndërkohë kryetari Begaj e ka shfrytëzuar këtë vizitë, për tu takuar me disa kryetar të komunave në Turqi, me të cilët kanë biseduar për mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë.

Po ashtu, kryetari Begaj, gjatë takimeve me përfaqësuesit e biznesit turk, i ka ftuar këta të fundit, që të investojnë në Malishevë, si dhe ju ka sqaruar edhe kushtet dhe lehtësirat që Komuna e Malishevës, ofron për bizneset.

Krasniqi: Malisheva më e mira në shpenzimin e buxhetit për vitin 2014

KPF-ja rekomandoi për kuvend, raportin financiar për vitin 2014

Krasniqi: Malisheva më e mira në shpenzimin e buxhetit për vitin 2014

Malishevë, 8 prill



Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës në Malishevë, i drejtuar nga kryesuesi z.Aziz Thaçi, dot ka mbajtur mbledhjen e radhës, ku mes tjerash ka rekomanduar për mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës, raportin financiar të vitin 2014 (janar-dhjetor 2014).

Para anëtarëve të KPF-së, raportin e ka prezantuar drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z.Vesel Krasniqi, i cili po ashtu tha se “bazuar në raportet e ministrisë përkatëse, Komuna e Malishevës, është e mira në vend për shfrytëzimin e buxhetit, pasi e ka relazuar 98 për qind të buxhetit”. Drejtori Krasniqi, po ashtu tha se “ janë tejkualuar edhe planifikimi për të hyrat vetanake, ku renditemi në vendin e gjashtë, në raport me komunat të cilat e kanë tejkualuar këtë planifikim”.

Përndryshe, KPF, i ka shtyrë për në ndonjë seancë tjetër raportin e punës së drejtorisë së shërbimeve publike, me arsyetimin që i njëjti raport përfshihet në raportin e Kryetarit të Komunës, që po ashtu pritet shumë shpejt të dal para Asamblesë Komunale, si dhe është shtyrë raporti i punës së Komitetit për Komunitete, pasi kryesuesi i këtij komiteti, ka kaluar në një pozitë tjetër dhe derisa të plotësohet vendi dhe zgjidhet kryesuesi i ri i këtij komiteti, u kërkua të mos del para Kuvendit.

Nexhmedin Spahiu promovon “foshnjërinë e kombit kosovar” në Malishevë

Malishevë, 8 prill



Publicisti Nexhmedin Spahiu, sot në Malishevë, ka promovuar librin e tij “Foshnjëria e kombit kosovar, ku para audiencës malishevase, autori i mundua ta arsyetoi çështjen e krijimit të kombit kosovar dhe dallimin mes etnisë dhe kombit. Kjo pavarësisht shpjegimit në versionin e autorit, të pranishmit, shumica prej tyre, nuk u pajtuan me mendimin e autorit.

Fillimisht, prof. Hazbi Gashi, foli për librin dhe për temën e shtjelluar, ku në fund tha se “ngritja e kombit kosovar, nuk është përçarje”, ndërsa vet autori, më pas e shpjegoi arsyen e shtjellimit të kësaj teme, sipas tij edhe “nevojën e krijimit të kombit kosovar, si një realitet dhe kombi si një pronar i shtetit”. Më pas këtë e arsyetoi edhe me nevojën që shqiptarët, në OKB të kenë dy vota, sepse sipas tij “OKB është organizatë e kombeve”. Autori Spahiu, në shumë raste, e krahasoi kombin kosovar dhe shqiptar, me mënyrën si janë krijuar popujt moldav nga rumunët, pastaj malazezët nga serbët dhe maqedonët nga bullgarët.

Megjithëse autori, e arsyetoi në versionin e tij në këtë temë, shumica e pjesëmarrësve nuk u pajtuan me teorinë e krijimit të kombit kosovar, pasi sipas tyre, “kanë shtetësinë kosovare, por si komb jemi shqiptar”. Disa prej pjesëmarrësve, e arsyetuan shtetin zviceran, i cili përbëhet nga tre popuj, pa qenë nevoja ta krijojnë një popull tjetër, ndërsa kishte të tillë, që hapjen e kësaj teme, e quajtën tentim për largimin e temave tjera më të rëndësishme dhe zëvendësimin me këtë temë, me qëllim të tërheqjes së vëmendjes së qytetarëve.

Por në mesin e audiencës, kishte edhe të tillë, që e përkrahnin idenë e kombit kosovar.

Mbi 400 mijë euro për rehabilitimin e ujësjellësve

Malishevë, 10 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot një takim informues me përfaqësuesit e njëmbëdhjetë fshatrave, të cilët janë përfitues të projektit për rehabilitimin e ujësjellësve, projekt i cili financohet nga Qeveria e Kosovës dhe Qeveria Zvicerane, dhe implementohet nga Hidroregjioni Jugor dhe CDI, në bashkëpunim të ngushtë, me Komunën e Malishevës. Me këtë rast, kryetari Begaj i ka informuar me detajet e realizimit të këtij projekti, i cili pritet të përfundoj brenda vitit 2015.

Kryetari Begaj, pasi i njoftoi përfaqësuesit e Bellanicës, Bardhit, Dragobilit, Kërvasarisë, Maxharrës, Guncatit, Panorcit, Rudit, Shkozës, Tërpezës dhe Astrazupit, kërkoi nga ata që si fshatra, të futen në sistemin e menaxhimit të ujësjellësve. “Futja nën menaxhim të ujësjellësve, është kushti kryesor i investitorit, andaj kërkohet nga ana juaj që të bisedoni me banorët dhe të pranoni të futeni në sistemin e menaxhimit të ujërave, pasi jo thjesht kusht, por është edhe siguri më e madhe për cilësinë e ujit që përdorim”. “Ne duhet të mësohemi jetojnë në formë institucionale, në këtë rast edhe me ujësjellësit, pasi ata ujësjellës duhet të menaxhohen nga dikush, duhet të mirëmbahen dhe duhet të sigurohemi se konsumojmë ujë cilësor”, tha mes tjerash kryetari Begaj.

Nga ana tjetër, kryetarët e fshatrave mirëpritën këto investime dhe u shprehën të gatshëm të bashkëpunojnë në kuadër të realizimit të projektit dhe të informimit të qytetarëve, në mënyrë që të pranojnë që ujësjellësi i tyre të menaxhohet nga ndërmarrja kompetente.

Projekti i rehabilitimit të ujësjellësve në këto fshatra, përfshinë rregullimin e defekteve, vendosjen e orë matësve dhe kyçjen e lagjeve të reja, të cilat nuk janë të kyçura në ujësjellësit ekzistues.

Rehabilitimi i këtyre ujësjellësve, kap një shumë prej mbi 400 mijë euro

Për mungesë kuorumi u ndërpre mbledhja e jashtëzakonshme

Malishevë, 14 prill



Kuvendi i Komunës së Malishevës, përkatësisht kryesuesi z.Aziz Thaçi, në bazë të ligjit, me kërkesën e njëmbëdhjetë anëtarëve të kuvendit, për “Gjendjen në arsimin e Komunës së Malishevës”, mirëpo kjo seancë u ndërpre, pasi shumica e anëtarëve të kuvendit, lëshuan sallën, para se të hidhej në votim ky rend i ditës. Paraprakisht, në këtë seancë, ka dhënë betimin, edhe dy anëtarët e rinj të kuvendit, nga radhët e LDK-së, z.Durim Krasniqi dhe z.Labinot Gashi, të cilët zëvendësojnë Sami

Kafexhollin dhe Fatmir Ademajn.

Në fillim të seancës, udhëheqësi i grupit të LDK-së në KK të Malishevës, z.Januz Kastrati, tha se grupi i LDK-së, nuk është për mbajtjen e seancës, pasi nuk kanë material për këtë pikë të rendit të ditës. Të njëjtën e gjë e tha edhe udhëheqësi i grupit të IQM-së, z.Avdi Morina, pasi përveç që ka mungesë material, për arsimin është diskutuar në mbledhjen e kaluar dhe pritet të diskutohet në mbledhjen e muajit të ardhshëm përsëri.

Përkundër kërkesës nga z.Valon Hoti i VV-së dhe z.Izet Morina i PDK-së, seanca nuk u mbajt, pasi anëtarët e IQM-së dhe LDK-së, lëshuan sallën, duke shkaktuar mungesë kuorumi.

15 fermerë përfitojnë përkrahjen e komunës për ndërtimin e serave

Malishevë, 14 prill



Drejtoria komunale për bujqësi, po vazhdon me përkrahjen e fermerëve në fushën e bujqësisë, përkatësisht në perime-kulturë. Në kuadër të kësaj përkrahje, sot edhe zyrtarisht ka filluar realizimi i projektit të bashkëfinancimit në ndërtimin e serave. Në fillimin e realizimit të këtij projekti, mori pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku dhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, me rastin e fillimit të ndërtimit të serës, së fermerit Halil Kastrati në

Bubël, i cili është në mesin e pesëmbëdhjetë përfituesve të kësaj përkrahjeje.


Sipas drejtorit për Bujqësi z.Hajrullah Mazreku, në Komunën e Malishevës do të ndërtohen pesëmbëdhjetë sera me nga 200 metër katror dhe ky projekt do të realizohet me bashkëfinancim, Komuna me fermerët, ku shumica e projektit është 35 940 euro, ku komuna financon 70 për qind të shumës dhe fermerët do të marrin pjesë me 30 për qind.

Drejtori Mazreku me këtë rast uroi të gjithë përfituesit e serave. “Investimet po vazhdojnë në sektorë të ndryshëm të lëmisë së bujqësisë, dhe sigurisht që përkrahja do të jetë e vazhdueshme për të gjithë fermerët, nga Komuna përkatësisht drejtoria për Bujqësi, dhe po shpresoj që do të kemi edhe shumë projekte tjera të radhës në të gjithë sektorët e bujqësisë ” tha drejtori Mazreku.



Kryetarët e fshatrave të Malishevës, kërkojnë zyrtarisht kthimin e Malishevës me regjionin e Prizrenit

Malishevë, 15 prill



Kryetarët e të gjitha fshatrave të Malishevës, kanë nënshkruar sot një shkresë, përmes së cilës i drejtohen Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Kuvendit të Komunës së Malishevës dhe Kryetarit të Komunës së Malishevës, me kërkesën për kthimin e të gjitha shërbimeve për nevojat e qytetarëve të Komunës së Malishevës, nga regjioni i Gjakovës, në regjionin e Prizrenit.

Këtë shkresë, sot e kanë përpiluar dhe nënshkruar kryetarët e fshatrave dhe vendbanimeve të Malishevës, gjatë takimi të mbajtur me kryetarin e Komunës së Malishevës, ku u kërkua që në çdo formë të përfillet vullneti i qytetarëve të Komunës së Malishevës, pasi kalimi në regjionin e Gjakovës, është bërë pa vullnetin e qytetarëve dhe me këtë, në mënyrë flagrante janë shkelur të drejtat e njeriut.

Po ashtu, gjatë diskutimit rreth kësaj teme, përveç kundërshtimit të fuqishëm, pati edhe kërkesa të tilla, që edhe qytetarët edhe institucionet, të bojkotojnë në çdo formë bashkëpunimin me regjionin e Gjakovës, dhe nëse kjo nuk arrihet, sipas tyre duhet të përdoren edhe format tjera, përfshi edhe protestat, bojkotimin e regjistrimit të veturave dhe të gjitha format tjera.

Sipas përfaqësuesve të fshatrave, Malisheva dhe vendbanimet e saj, i kanë të gjitha lidhjet me regjionin e Prizrenit, përfshi numrin e madh të lidhjeve të familjare, infrastrukturën, lidhjet ekonomike, e po ashtu edhe lidhjet natyrore. Kishte të tillë, që thanë se “edhe zoti, si regjion e ka ndarë përmes Drinit (lumit) me Gjakovën, dhe Malisheva nuk ka as linjë të autobusit me Gjakovë, e lëre më lidhje tjera”.

(Këtë kërkesë, e kanë nënshkruar 40 përfaqësues të vendbanimeve të Komunës së Malishevës,, të cilët ishin prezent në këtë takim, ndërsa edhe gjashtë të tjerë që nuk ishin prezent, e kanë konfirmuar se e përkrahin këtë dhe janë për kthimin në regjionin e Prizrenit, por që për arsye objektive, nuk kanë mundur të marrin pjesë sot në takim).

U mbajt dëgjimi i parë publik për tri rregullore

Malishevë, 15 prill



Sot në sallën e Kuvendit të Komunës së Malishevës, u mbajt debati-konsulta publike, e para për tri rregullore të ndryshme, e ku qytetarët dhe grupet interesit i kanë dhënë mendimet e para, para se të kaloj në dëgjimin e dytë publik, e më pas në Asamblenë Komunale për miratim të Rregullores për ndarjen subvencioneve dhe transfereve, asaj për ndarjen e bursave për student dhe rregullores për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike.

Në këtë debat-konsult publike, me qytetar dhe grupet e interesit, Kryetari Begaj, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit e këtij takim ku më pas tha. “ Prezenca juaj këtu është shumë e rëndësishme, për arsye se çdo vërejtje dhe sugjerim i juaji na ndihmon edhe neve për hartimi e këtyre rregulloreve”.

Ndër tjera drejtori për buxhet dhe financa Vesel Krasniqi, ka prezantuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, drejtori i arsimit, Blerim Thaçi, atë për ndarjen e bursave dhe drejtori i shërbimeve publike, Milazim Morina, rregulloren për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike.

Pasi drejtorët, i kanë prezantuar draft rregulloret para të pranishmëve, këta të fundit, i kanë dhënë mendimet dhe propozime e tyre për nenet dhe pikat e caktuara të rregulloreve.

Pas këtij dëgjimi, këto rregullore, do të dalin edhe në dëgjimin e dytë publik, ku qytetarët dhe grupet e interesit, do ti paraqesin me shkrim propozimet e tyre konkrete për këto rregullore, dhe pas kësaj, rregulloret e harmonizuara në bazë të ligjit dhe të propozimeve të marra nga këto dëgjime, do ti paraqiten Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Përfundoi asfaltimi i rrugës në fshatin Burim

Malishevë, 16 prill



Në kuadër të angazhimeve të Komunës së Malishevës, për rregullimin e përgjithshëm të infrastrukturës rrugore, me qëllim të përmirësimit të jetesës së qytetarëve nëpër vendbanimet e saj, ka përfunduar asfaltimi i dy segmenteve të rrugëve në fshatin Burim (ish Joviç), duke ju mundësuar një pjese të këtij fshati, që të lidhen me shiritin kryesor të rrugës, që lidh fshatin me qendrën komunale të Malishevës.

Këtë ndërtim të rrugës, sot e ka vizituar edhe kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, për tu njohur në mënyrë të drejtpërdrejtë me kryerjen e punimeve në këtë rrugë, dhe me këtë rast i ka uruar banorët e këtij fshati për asfaltimin e dy segmenteve të rrugëve.

Projekti për ndërtimin e kësaj rruge, ka qenë projekt dyvjeçar, ku në vitin 2014 është bërë zgjerimi dhe përgatitja e bazës për asfaltim, ndërsa këtë vit, është ka përfunduar asfaltimi i rrugës.

Këto dy segmente të kësaj rruge, kanë një gjatësi prej 1080 metra, dhe asfaltimi i saj, buxhetit komunal i ka kushtuar 68 mijë e 460 euro.

Ka filluar pastrimi i ambientit

Malishevë, 16 prill



Ambienti edhe këtë vit, do të vazhdoj të mbetet njëri prej prioriteteve kryesore të qeverisë komunale, të drejtuar nga kryetari Begaj dhe për këtë qëllim, përsëri ka filluar pastrimi i ambientet, me qëllim të eliminimit të deponive ilegale të grumbullimit të mbeturinave, në ato “pika të zeza” që janë evidentuara nga inspektorati komunal dhe shërbimet publike.

Përderisa gjatë ditës së djeshme, është bërë pastrimi i ambientit në fshatin Guncat, sot ky aksion ka

vazhduar në fshati Bardh, ku gjenden disa deponi të tilla, e në mesin e tyre njëra shumë e rrezikshme për ambientin, pasi në të hidhen mbetjet nga djegia e furrave për përfitim të gëlqerës, e ku deri më tani janë përdorur gomat për djegie, mbetje të cilat konsiderohen edhe kancerogjene, ku përveç hirit ka edhe mbetje të telave të metalit nga gomat.

Aksionin e largimit të mbeturinave, e ka parë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ku me këtë rast ka kërkuar nga banorët e këtij fshati, që ti mbyllin këto furra dhe të merren me veprimtari tjetër, pasi me këtë po ndotet rëndë ambienti dhe po rrezikohet seriozisht edhe shëndeti i banorëve të fshatit, pasi çdo gjë përreth po ndotet me pluhurin nga mbetjet e djegies së furrave.

Përndryshe, Drejtoria për Shërbime Publike, në bashkëpunim me ndërmarrjen për menaxhimin e mbeturinave “Eko regjioni”, njësia në Malishevë, janë duke bërë largimin dhe në vende të caktuara edhe varrosjen e mbeturinave, nëpër deponitë ilegale të hedhjes së mbeturinave nga ana e personave të papërgjegjshëm.

Pastrimi i ambientit, do të vazhdoj deri në largimin e të gjitha deponive të tilla, dhe me këtë rast ju bëhet thirrje qytetarëve që të mos i hedhin mbeturinat në vende ku ndotet ambienti dhe rrezikohet jeta e qytetarëve.



KPF mbajti mbledhjen e radhës

Malishevë, 17 prill



Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi i KK-së. z.Aziz Thaçi, ka mbajtur mbledhjen e katërt të radhës, ku kanë dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale.

Rekomandimet e dhëna për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nga anëtarët e KPF-së janë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së kryetarit të Komunës dhe qeverisë Komunale

në Malishevë (Janar-dhjetor 2014), Rishqyrtimi i mundësisë për rikthim nga Regjioni i Gjakovës, në Regjionin e Prizrenit, shqyrtimi dhe miratimi i dy kërkesave të kryetarit të Komunës a) Kërkesa për inicimin e procedurave për kompensimin e pronës së eksproprijuar të z.Halit Sinan Mazreku nga Malisheva dhe b) Kërkesa për ndërrim, destinimë të pronës bujqësore në atë ndërtimore .

U mbajt tribuna profesionale për EHKK dhe masat parandaluese

Malishevë, 17 prill



Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot në Malishevë, është organizuar një tribunë profesionale me temën “Ethet hemorragjike krime kongo (EHKK) dhe masat parandaluese”, ku u prezantuan rreziqet që shkakton virusi i etheve hemorragjike krime kongo dhe masat që marrin institucionet përgjegjëse. Në këtë temë, prezantime e tyre i bënë, drejtoresha Institutit Rajonal të Shëndetit Publik (IRSHP) në Prizren, znj.Nurishahe Hulaj, z.Shaban Gollopeni

nga Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës (AVUK) dhe z.Besim Zogaj, drejtor i QKMF-së në Malishevë.

Fillimisht një fjalë rasti e mbajti kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili i falënderoi të gjithë për angazhimin e tyre në luftimin dhe parandalimin e EHKK, duke filluar nga puna e QKMF-së në Malishevë, e deri në nivelin qendror. Kryetari Begaj, adresoi kritikë për Këshillin Ndërmintor për këtë vit, pasi ende nuk është aktiv, por kërkoi angazhimin e të gjithë faktorëve për siç tha Begaj, “për ta mposhtur këtë të keqe”.

Nurishahe Hulaj, nga IRSHP-ja, për masat për mbrojtje ndaj etheve dhe për rolin e institutit. Më pas, drejtoresha Hulaj paraqiti edhe disa të dhëna, ku sipas të dhënave të grumbulluara, nga paslufta në Malishevë, kanë vdekur 18 persona nga EHKK, apo marr në përqindje në nivel vendi janë 51 përqind. Ndërsa kategoria më e prekur nga thumbimet e rriqrave janë fëmijët. Më pas duke folur për format e infektimit me EHKK, sipas drejtoreshës Hulaj, ky virus bartet nga rriqrat, nga minjtë dhe nga urithi. “Kontrollimi i shpeshtë i trupit, kositja e barit, dezinfektimi i stallave, veshja e duhur gjatë punëve të përditshme janë disa nga masat dhe format e vetkujdesit.

Ndërsa z.Shaban Gollopeni nga AVUK-i, tha se “ciklin e zhvillimit të rriqrave e ndihmojnë shumë edhe kafshët, dhe për këtë arsye agjencioni, po bën repelimin e kafshëve, me qëllim të përpjekjes për parandalimin e zhvillimit të ciklit”. Gollopeni, foli për masat që AVUK është duke ndërmarrë në kuadër të zbatimit të strategjisë për luftimin dhe parandalimin e EHKK.

Kurse z.Besim Zogaj nga QKMF e Malishevës foli për angazhimet e QKMF-së në trajtimin e pacientëve, analizat në laborator dhe për fushatat informuese për vetëdijesim. “QKMF ka një



personel të trajnuar shumë mirë dhe trajtimi i rasteve të thumbimit nga rriqrat, bëhet në mënyrën më profesionale, si dhe përcillet në vazhdimësi pacienti, përmes analizave laboratorike”, tha drejtori Zogaj.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë Komunale për Shëndetësi, z.Hajdin Berisha, foli për masat që komuna ka ndërmarrë gjatë vitit të kaluar dhe për masat që janë duke marrë gjatë këtij viti.

Më pas, të pranishmit në sallë, kanë dhënë mendimet dhe propozimet e tyre, lidhur me çështjen e EHKK, ku sipas tyre, duhet të rriten kapacitetet për luftimin dhe parandalimin e EHKK.

Përndryshe në vitin 2014 në Komunën e Malishevës, ishin të paraqitura katër raste me EHKK, kurse këtë vit, ende nuk ka raste të regjistruara me EHKK edhe pse numri i të thumbuarve nga rriqrat, gjatë këtij viti sillet në rreth tridhjetë raste të thumbuara.

U mbajt testi ndërkombëtar PISA me nxënësit nga Malisheva

Malishevë, 17 prill

Sot në Komunën e Malishevës u mbajt testi ndërkombëtar PISA (Programme for International Student Assessment), për vlerësimin e nxënësve në: Lexim, Shkencat e Natyrës dhe në Matematikë. Qëllimi i këtij vlerësimi në këtë test është perceptimi i shkallës së arritshmërisë në raport me rrjedhat e përgjithshme shoqërore, ku këtij testi ju nënshtrohen nxënësit e moshës 15 vjeçare.

Nga Komuna e Malishevës në këtë vit morën pjesë 6 shkolla filloret të mesme të ulëta. “Fehim Agani” nga Turjaka, ”Hilmi Hoti” nga Carralluka, “Naim Frashëri” nga Banja, “Afrim Buçaj” nga Lladroci, “Labinot Krasniqi” nga Mirusha, dhe “Nuhi Mazreku” nga Guriqi. Këto shkolla e mbajtën testin në SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë. Numri i nxënësve pjesëmarrës në këtë vlerësim ishte 30 nxënës.

Gjithashtu në këtë test vlerësuesi ishin të përfshira edhe Gjimnazi” Hamdi Berisha” me 35 nxënës, Qendra e Kompetencës me 35 nxënës dhe SHMP “Lasgush Poradeci” me 35 nxënës. Testi vlerësues u mbajt në shkollat përkatëse bëri të ditur drejtori për Arsim dhe Edukim z.Blerim Thaçi.

PISA është vlerësim i jashtëm që matë njohuritë e nxënësve 15-vjeçar në lexim, matematikë dhe shkencë. PISA është studimi më i madh ndërkombëtar për arsimin, i cili fokusohet në aftësinë që kanë nxënësit 15-vjeçar për t’i përdorur dijet dhe njohuritë e fituara në shkollë në situatat reale të jetës të një të rrituri. Vlerësimi PISA, konsiderohet si një ndër vlerësimet me besueshmëri më të



lartë dhe me ndikim të rëndësishëm në hartimin e politikave arsimore. Rezultatet e testit vlerësues PISA 2015 do të publikohen në vitin e ardhshëm. Testi PISA organizohet në çdo tri vjet.

Po vazhdon realizimi i disa projekteve

Malishevë, 20 prill

Drejtuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot është mbajtur mbledhja e rregullt e qeverisë komunale, ku drejtorët e drejtorive kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e drejtorive që ata drejtojnë. Sipas tyre, aktualisht kanë përfunduar apo janë në realizim disa nga projektet në infrastrukturë në përgjithësi, si rrugë, shkolla dhe infrastrukturë tjetër, si dhe po vazhdon edhe pastrimi i ambientit.

Sipas drejtorit të urbanizimit, z.Skënder Rrahmanaj, ka përfunduar asfaltimi i një rruge, si dhe janë duke vazhduar punimet në disa rrugë tjera, në përgatitje për asfaltim dhe rregullime tjera, ndërsa janë duke vazhduar punimet në dy shkolla, në atë të Gurishtës dhe të Carrallukës. Kurse drejtori i arsimit, z.Blerim Thaçi, tha se gjatë javës së kaluar, është mbajtur testi i arritshmërisë PISA, për nxënësit e moshës 15 vjeçare, ndërsa si drejtori janë në përgatitje të organizimit dhe mbajtjes së testit të maturës për këtë vit.

Drejtori i shërbimeve publike, z.Milazim Morina, tha se është duke vazhduar pastrimi i ambientit, përkatësisht largimi i deponive ilegale të mbeturinave. Drejtori Morina, po ashtu ka bërë të ditur, se janë në përgatitje edhe të procedurave për pishinat e Banjës, me qëllim të fillimit të sezonit turistik veror.

Në fushën e shëndetësisë, sipas drejtorit të kësaj drejtorie, z.Hajdin Berisha, pas mbajtjes së tribunës profesionale, për ethet hemorragjike, për këtë temë, gjatë kësaj jave, do të mbahet edhe një konferencë për “Ethet Hemorragjike Krime-Kongo në Kosovë”. Sipas drejtorit Berisha, numri i të thumbuarve nga rriqrat gjatë këtij viti është 34 persona, shifër më vogël se në vitin paraprak.

Ndërsa drejtori për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, tha se është duke vazhduar përkrahja në bujqësi, si në ndërtimin e serrave, ku komuna i ka përkrahur në formë të bashkëfinancimit, po ashtu edhe në fusha të tjera të bujqësisë.

Përmirësohen kushtet e punës për shërbimin zjarrfikësve dhe shpëtimin në Malishevë

Malishevë, 20 prill



Në kuadër të përmirësimit të kushteve të punës së shërbimit të zjarrfikësve dhe të shpëtimit në Komunën e Malishevës, ditëve të fundit, ky shërbim është pajisur me një automjet të ndërhyrjes së shpejt, nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Me këtë rast kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, pas vizitës në këtë shërbim, e ka falënderuar ministrinë, për këtë ndihmë, e cila e lehtëson punën e këtij shërbimi, me shumë rëndësi për

qytetarët e Komunës së Malishevës.

Sipas drejtorit të drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina, ky automjet, me kapacitet të ujit prej një mijë litrash, “është i pajisur me mjete përcjellëse, si gjenerator dhe mjete tjera dhe ndikon jashtëzakonisht shumë në rastet e ndërhyrjes së shpejt, duke e rritur kështu sigurinë në mbrojtjen e jetës së qytetarëve, pasi me këtë automjet, shpejtësia e ndërhyrjes është shumë më e madhe, se me automjetet tjera”.

Pas vizitës në shërbimin e shpëtimit dhe zjarrfikësve, kryetari Begaj, e falënderoi ministrinë për këtë donacion, ndërsa uroi që ky shërbim të ketë sa më pak punë.

Vlera e automjetit për ndyrje të shpejt, donacion nga Ministria e punëve të Brendshme, është afro 150 mijë euro, ndërsa ky automjet i ndërhyrjes së shpejt, e lehtëson në masë të madhe punën e shërbimit të zjarrfikësve dhe shpëtimit në Malishevë.

Përndryshe, edhe Komuna e Malishevës, gjatë vitit të kaluar, ka bërë disa investime në përmirësimin e kushteve të punës për këtë shërbim.

Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e shoqatës QAD

Malishevë, 21 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj , ka pritur sot në zyrën e tij përfaqësuesit e Shoqatës Joqeveritar “Qendra për Avokim dhe Diplomaci” (QAD), përkatësisht drejtorin e kësaj shoqate, z.Valmir Hajrullahu, me të cilin ka biseduar rreth zhvillimit të bujqësisë, kulturës dhe rreth të ardhmes së frytshme të rinisë dhe kontributit që rinia mund ti sjell vendit.

Fillimisht Kryetari Begaj i falënderoi për vizitën dhe kontributin e tyre që po japin për vendin. ”Unë jam i interesuar që ti përkrahi në përgjithësi njerëzit e komunës së Malishevës, e sidomos juve të rinjve, që jeni e ardhja e ndritshme për ndërtimin dhe zhvillimin e vendit. Ju jeni ata që mund të kontribuoni, për të ardhmen, si në bujqësi, kulturë e në sektor tjerë nga më të ndryshëm, mirëpo për të arritur këtë, ne duhet të punojmë shumë dhe kjo arrihet vetëm me një shoqëri të dobishme, që punojnë drejt e në të mirë të vendit” tha Begaj para të rinjve gjatë këtij takimi.

Edhe përfaqësuesit e kësaj shoqate, e falënderuan kryetarin Begaj për mirëpritjen, ku dhe e njoftuan kryetarin për disa aktivitete të cilat i realizon kjo shoqatë këtu së bashku me disa të rinj të Malishevës, ku kanë shpërndarë grande për bujqësi, bursa për nxënësit, pastaj kanë mbajtur disa shfaqje teatrale për sensibilizim të shoqërisë kundër migrimit jashtë vendit.

Ekipe të shpëtimit, shpëtojnë banorët e qendrës së banimit social nga zjarri

Zjarr i fuqishëm në qendrën e banimit social

Ekipe të shpëtimit, shpëtojnë banorët e qendrës së banimit social nga zjarri

Malishevë, 21 prill



Sot në qendrën e banimit social në Malishevë, ku banojnë 24 familje, ka shpërthyer një zjarr në njëren prej banesave, me ç'rast janë rrezikuar seriozisht të gjithë banorët e kësaj ndërtese, por falë ndërhyrjes së shpejt të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (SHZSH) në Malishevë, të gjithë banorët janë larguar nga ndërtesa dhe është shuar zjarri. Si pasojë nëntë persona janë lënduar rëndë dhe lehtë, të cilët janë dërguar në QKUK në Prishtinë, ndërsa ndërtesa ka pësuar dëme të konsiderueshme.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Ahmet Morina, ekipi i SHZSH në Malishevë, në ora 05:28 të mëngjesit ka pranuar thirrjen nga qendra e alarmimit dhe menjëherë kanë dalë në vend ngjarje, dhe falë këtij intervenimi të shpejtë, kanë arritur të shpëtojnë banorët në këtë qendër.

Sipas drejtorit Morina, “ më të rrezikuar kanë qenë banorët e kateve të sipërme, të ndërtesës pesë katërshe, ku si pasojë e zjarrit dhe tymit, ka qenë e pamundur dalja nga objekti, dhe banorët janë nxjerrë nga katet përmes dritareve, me litar dhe me shkallë të zjarrfikësve, ndërsa gjatë intervenimit ka pasur edhe një shpërthim të një bombole gazi”.

Në vendngjarje, ka dalë edhe Policia e Kosovës, ndërsa ndihmën e parë të lënduarve, ju ka dhënë emergjenca në QKMF të Malishevës. Në këtë ngjarje të dhimbshme, është parë një mobilizim dhe intervenim i jashtëzakonshëm i ekipeve të SHZSH-së, ku përveç zyrtarëve në detyrë, janë angazhuar edhe ekipet rezervë, pastaj edhe QKMF e Malishevës, ka qenë në krye të detyrës, duke ofruar ndihmën e parë për të gjithë të lënduarit, ndërsa drejtori Morina, ka falënderuar edhe SHZSH të Suharekës për gatishmërinë e treguar, të cilët po ashtu ju kanë ardhur në ndihmë SHZSH-së në Malishevë.

Në vendin e ngjarjes, krahas zyrtarëve tjerë, ka dalë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili ju ka dëshiruar shërim të shpejt të lënduarve, e më pas e ka vizituar edhe emergjencën e QKMF-së në Malishevë. Me këtë rast kryetari Begaj, i ka falënderuar ekipet e SHZSH-së dhe të emergjencës në QMKF, për angazhimin e jashtëzakonshëm për shpëtimin e jetës së banorëve, të cilët kanë jetuar në këtë qendër dhe sot janë përballur me një rrezik, që ka mundur të ketë pasoja katastrofave.

“Angazhimi i ekipeve të SHZSH-së dhe ndihma e Policisë së Kosovës dhe personelit në QMKF, ka bërë që sot këta banorë të jenë gjallë dhe të mos ketë pasoja me jetën nga zjarri sotëm”, ka thënë Begaj.

Shkaku i zjarrit ende nuk dihet, ndërsa drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina dhe ai Shërbimeve Publike, z.Milazim Morina, aktualisht janë duke u marrë me planin për strehimin e banorëve, të cilët nuk mund të kthehen momentalisht në këtë objekt, për shkak të çështjeve të mëdha nga zjarri.

U mbajt konferenca “Ethet hemorragjike krime-kongo në Kosovë”

Malishevë, 24 prill



Organizuar nga Shoqata e Infektologëve të Kosovës dhe Qendra e Mjekësisë Familjare në Malishevë, sot është mbajtur një konferencë njëditore në nivel të vendit, me temën “Ethet hemorragjike krime kongo në Kosovë”, ku morën pjesë infektologët kosovar, Kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ministri i Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, z.Ferid Agani, deputetja e Kuvendit të Kosovës, znj.Shukrije Bytyçi, përfaqësuesit nga ministria e shëndetësisë, përfaqësuesit përgjegjës komunal, Peter

Deplaces, parazitolog nga Zivcra, përfaqësues të Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Kosovë, dhe rreth 250 pjesëmarrës nga fusha e shëndetësisë, epidemiologjisë dhe fushat tjera që ndërlidhen me ethet hemorragjike krime-kongo.

Në hapje të kësaj konference, përderisa ministri Agani, e quajti sfidë problemin e EHKK-së, kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, i falënderoi të gjithë për angazhimin e tyre të deritanishëm, dhe kërkoi që të vazhdohet me punën e tyre nga institucionet përgjegjëse vendore, për luftimin



dhe parandalimin e kësaj të keqe. Ndërsa dekani i Fakultetit të Mjekësisë në UP, Sali Ahmeti, këtë konferencë dhe këtë temë, e quajti “të qëlluar në kohën dhe në vendin e duhur”.

Më pas, ka vazhduar konferenca sipas planifikimit, ku u fillua me prezantimin: “Ecuria e thumbimeve nga rriqrat nga viti 2007-2015 në Komunën e Malishevës”. Sipas këtyre të dhënave, në vitin 2013, janë shënuar më shumë raste të thumbimit 2686, 17 të infektuar dhe 6 të vdekur. Sipas të dhënave të grumbulluara, në vitin 2007, janë regjistruar më shumti raste me virusin e EHKK, ndërsa në vitin 2013, ka pasur më shumtë vdekje. Nga paslufta, në Malishevë, kanë vdekur 18 persona nga EHKK, prej tyre, 12 meshkuj dhe 6 femra, dhe mosha mesatare sillet rreth 35 vjeç. Ky prezantim u bë nga personeli mjekësor i QKMF-së në Malishevë.

Ndërsa për “Karakteristikat e EHKK në rajonin e Prizrenit, me theks të veçantë në Malishevë”, e prezantoi drejtoresha e Institutit Rajonal të Shëndetit Publik, Nurishahe Hulaj. Ndërsa “vështrimin e EHKK në Kosovë, e paraqiti, Sali Ahmeti, sipas të cilit, ky shtam i virusit, është i emëruar Kosova-Hoti dhe është një virus vdekjeprurës. Foli për patofiziologjinë e EHKK. Ahmeti tha se në vitin 1954 në Kosovës janë paraqitur për herë të parë janë paraqitur EHKK në Nishor të Therandës. Sipas të dhënave, në vitin 1995 është shënuar viti më i rëndë i shpërthimit të kësaj epidemie, ku janë shënuar 46 raste me EHKK. Sipas Ahmetit, Malisheva, vazhdon të mbetet vatër natyrore e EHKK-së, por kjo varet edhe prej shumë faktorëve, e sidomos klimës. Maji, qershori dhe korriku, mbeten muajt kur ka më shumë raste, ndërsa sipas të dhënave, në aspektin gjinor, tek meshkujt janë shënuar më shumë raste të prekjes nga EHKK. Ahmeti, i paraqiti edhe format e veçanta klinike dhe ngjashmëritë e simptomave të EHKK me Ebollën trajtimin e sëmundjes dhe të tjera.

Për kujdesin primar shëndetësor për EHKK, foli, drejtori i QKMF-së në Malishevë, Besim Zogaj. Zogaj, i paraqiti në formë kronologjike të gjitha masat dhe kujdesin shëndetësor, që bëhet në nivelin primar të shëndetësisë, duke filluar nga ligjëratat që mbajnë në shkolla dhe vende tjera, largimi i rriqrave, menaxhimin e rasteve të dyshimta dhe organizimi i punës në përgjithësi, për trajtimin e rasteve.

“Predikorët e fatalitetit të EHKK gjatë epidemisë në vitin 2013”, i paraqiti L.Ajazaj. sipas saj, 42.8 për qind e rasteve me EHKK, kanë përfunduar me fatalitet. Mosha nga e personave me EHKK ka qenë nga 0-75 vjeç. Doktoresha Ajazaj, i paraqiti në formë grafike të gjitha të dhënat nga hulumtimi, si rastet e dyshuara, rastet me EHKK dhe ato me fatalitetit, simptomat, manifestimet hemorragjike, manifestimet gastrointestinale, hepatite, kardiovaskulare, pulmonare, renale dhe nervore. Po ashtu u paraqitën edhe parametrat hematologjik dhe të dhëna të tjera të predikorëve të fatalitetit. Sipas saj, EHKK është një sëmundje kontagjioze me manifestime klinike të larmishme dhe zona endemike konsiderohet gjysma e komunave të vendit tonë.

Për detektimin e shtameve të virusit të EHKK në rriqrat në Kosovë, e prezantoi Kurtesh Sherifi, nga fakulteti i Bujqësisë, dega e veterinarisë. Profesori Sherifi, foli për përhapjen e llojeve të rriqrave si vektor të sëmundjes, detektimin e virusit dhe prania e virusit në rriqra. Prejardhja e shtameve të virusit është e ndryshme. Në Malishevë, dominon rriqra Hyalomma, e cila është edhe bartëse. Sipas tij, bazuar në analiza dh hulumtimet e bëra, virusi i shtamit Kosova Hoti, ka prejardhjen nga Turqia, rreth 35 vjet më parë. Ky shtam ka ngjashmëri me shtamin Drozdov.

Ndërsa shtami Kosova 1, ka preajdhurje prej Greqisë, 63 vite më parë. Sipas tij, nga hulumtimet e bëra, njëri nga rekomandimet është repelimi i kafshëve, si masë parandaluese për ndërprerjen e ciklit të shumimit të rriqrave. Përderisa, ende nuk kanë përfundime për rolin e kafshëve të egra në këtë drejtim, për çka janë duke punuar në këtë drejtim.

Ndërsa, nuk u prezantuan edhe dy temat e planifikuara për strategjinë për luftimin dhe parandalimin e EHKK dhe për masat mbrojtëse, ku munguan Naser Ramadani nga IKSHP dhe Ismete Humolli, të cilët i kishin paraqitur temat e tyre për prezantim në këtë konferencë.

Në fund të takimit, u zhvillua edhe një diskutim, lidhur me temat e prezantuara, ku u bënë pyetje të ndryshme rreth temave dhe problematikës së EHKK, të paraqitura nga prezantuesit e temave të trajtuara në këtë konferencë.

Florian Begaj dhe Adelina Javori, fitues të krosit pranveror

Në Malishevë, u mbajt krosi pranveror

Florian Begaj dhe Adelina Javori, fitues të krosit pranveror

Malishevë, 24 prill



Drejtorja për Arsim dhe Edukim, drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Malishevës dhe Shoqata e pedagogëve të Sportit Shkollor organizuan krosin komunal për shkolla të mesme të ulëta, të mesme të larta dhe për qytetar.

Pjesëmarrës në këtë kros ishin shumica e shkollave të mesme të ulëta, të mesme të larta dhe qytetar të Komunës së Malishevës dhe numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve, ishte 250 vrapues.

Pjesëmarrësi më i ri në këtë kros ishte Lorent Mazreku i cili është vetëm 8 vjeçar.

Organizatori për të gjithë fituesit ndau kupa, medalje dhe diploma.



Kryetari Begaj në përkrahje të familjarëve të të pagjeturve

Malishevë, 24 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip begaj, ka pritur sot një delegacion të Këshillit koordinues të shoqatave të të pagjeturve të Kosovës dhe z.Prenk Gjeta, kryetar i komisionit qeveritar për të pagjeturit, me të cilët ka biseduar për çështje të ndryshme, si dhe ju ka dhënë përkrahjen e tij për punën e asociacionit, përkatësisht në krijimin e kushteve për mbledhjen e fakteve, që të bëhet padi ndaj shtetit serb dhe personave, përgjegjës për vrasjet dhe zhdukjen e qytetarëve, gjatë luftës.

Fillimisht z.Prenk Gjetaj, e faldneroi kryetarin Begaj, për pritjen, e më pas e njoftoi me punën dhe angazhimin e zyrës që ai drejton, si dhe e njoftoi me punën e bërë për ngritjen e përmendores për të pagjeturit që pritet të zbulohet të hënën në oborrin e Kuvendit të Kosovës.

Më pas kryetari Begaj, duke ju drejtuar delegacioni të asociacionit të shoqatave të të pagjeturve, ju tha se “është pjesë e dhimbjes së tyre dhe përkrah tyre, edhe pse nuk është e lehta dhimbja që ata kanë”. “Kjo kategori, nuk është trajtuar si duhet dhe institucionet tona nuk janë marrë seriozisht me çështjen e të pagjeturve, pasi është dashur që menjëherë të merren me gjetjen e personave të humbur dhe të mos pranohet asnjë lloj bisede me shtetin serb, pa gjetjen e atyre që ata i kanë zhdukur”, tha kryetari Begaj.

Ndërsa z.Bajram Qerkini, në emër të këshillit korrodiues, tha se “neve po na vajtojnë shumë, po ne duam punë konkrete e jo të na vajtojnë”. Sipas tij, kemi ende edhe rreth 1600 persona të pagjetur dhe ne si këshill, jemi duke punuar në gjetjen e fakteve të të gjitha rasteve dhe jemi në proces të ngritjes së padive për të gjitha krimet.

Për këtë, kryetari Begaj, ju premtoi se do të angazhohet në gjetjen e një zyre, për avokatin e shoqatave dhe ta përkrah në gjetjen dhe grumbullimin e dokumentacionit për ngritjen e padive, për të gjitha rastet e krimeve.

Më pas, u vizituan edhe varrezat e dëshmorëve në Malishevë, ku vendosën buqeta me lule dhe u bënë homazhe pranë varreve të dëshmorëve të kombit në Malishevë.



Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Malishevë, 27 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, si çdo të hëne, edhe sot ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ku janë trajtuar çështje të ndryshme, që lidhen me aktivitetet e përditshme të qeverisë komunale, e me këtë rast, drejtorët e drejtorive kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e drejtorive që ata drejtojnë, për javën që lamë pas dhe për planifikimi për javën në vijim.

Gjatë këtij takimi, drejtoi për Urbanizëm z.Skënder Rrahmanaj, bëri të ditur që dinamika e punëve të kësaj drejtorie për realizimin e projekteve është shtuar, ku sipas tij “ne veç vazhdimet të projekteve që janë në realizim, kemi filluar edhe me punimin e rrugës në Berishë, po vazhdon ndërtimi i rrugës në Kërvasari, shkolla në Bubavec, pastaj punimet në fushën e sportit në shkollën “Visar Krasniqi“ në Drenoc, e po ashtu kemi filluar edhe me projektin e mirëmbajtjeve të rrugëve”.

Nga ana tjetër drejtori për Shëndetësi z.Hajdin Berisha njoftoi se javën e kaluar është mbajtur konferenca për “Ethet Hemorragjike Krime-Kongo në Kosovë”, e cila ka qenë një konferencë e gjerë, me pjesëmarrje të madhe të ekspertëve të fushës së caktuar. Ndërsa sa i përket thumbimit të rriqrave, deri më tani shënuar 55 raste dhe ky numër është dukshëm me i ulët se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Drejtori Berisha njoftoi se në kuadër të javës ndërkombëtare të imunizimit, edhe në Malishevë, do shënohet kjo datë, përderisa Malisheva, është njëra prej komunave më të mira në vend, në fushën e imunizimit të popullatës.

Ndërsa drejtoresha për Kulturë Rini e Sport znj.Blerta Krasniqi bëri të ditur se kjo drejtori ka filluar përgatitjet rreth organizimit të 16 Qershorit – Ditës Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimit të Malishevës.

Ndërsa drejtori për Bujqësi z.Hajrullah Mazreku tha që përkrahja po vazhdon për fermerët dhe bujqësinë në përgjithësi.

Historiani Imeraj, promovoi projektin mbi gjenocidin

Malishevë, 27 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim z.Shkodran Imeraj, anëtar i Institutit të Historisë, ku i fundit, e promovoi projektin për “gjenocidin në Kosovë”. Ky projekt, është në nivel të vendit dhe promovohet në shtatë komuna të Kosovës.

“Kam menduar se do ta kemi një shtet më ndryshe, kam shpresuar për më mirë, por deri më tani nuk ka shkuar çdo gjë për së mbari. Por unë shpresoj se gjërat do të lëvizin në drejtimin duhur”, tha kryetari Begaj, në këtë takim, pasi e uroi historian Imeraj, për angazhimin e tij në këtë fushë të hulumtimit të gjenocidit dhe masakrave në Kosovë, gjatë luftës.

Historiani Imeraj, ja dorëzoi kryetarit Begaj, botimin e tij lidhur me masakrat e Lubeniqit, vendit, ku gjatë luftës së fundit, është regjistruar edhe si njëra prej masakrave më të mëdha në vend. Ai më pas, shprehi gatishmërinë e tij edhe për hulumtimin e masakrës së Burimit, dhe rrjedhimisht, botimin e një libri historik lidhur me këtë masakër, që hyn në mesin e masakrave më të mëdha, gjatë luftës në Kosovë.

Një kompani holandeze, interesohet për të investuar në Malishevë

Malishevë, 27 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën e tij, përfaqësuesit e një kompanie holandeze, të cilët janë të interesuar të investojnë në Malishevë. Qëllimi i vizitës së tyre, ishte njohja me kushtet dhe mundësitë që jep komuna, për bizneset dhe njohja me të parin e Komunës së Malishevës.

Me këtë rast, kryetari Begaj, i ka falënderuar, përfaqësuesit e Kompanisë “TFD” nga Holanda që kanë zgjedhur Malishevën, si një vend ku mund të investohet, dhe i ka njoftuar ata me kushtet dhe mundësitë që institucioni i komunës, jep për bizneset, sidomos ato prodhuese. “Ne si komunë, kemi hequr taksat komunale dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me dokumentacionin, ju ofrojnë shërbim shumë të shpejt, në mënyrë që biznesi, të mos ketë nevojë të presë për nxjerrjen e një dokumenti”, tha Begaj.

Po ashtu përfaqësuesit e kompanisë “TFD” nga Holanda, falënderuan kryetarin Begaj për mikpritjen dhe më pas e njoftuan për veprimtarin e tyre prodhuese, dhe shprehën interesimin e tyre, që të bashkëpunojnë me Komunën e Malishevës, përderisa, sipas tyre, në fazën e parë, mendojnë të punësojnë deri në 40 persona.

Kryetari Begaj, paraqiti para Kuvendit të Komunës, raportin e punës për vitin 2014

Malishevë, 30 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj, ka paraqitur para anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës, raportin e punës të Qeverisë Komunale për vitin 2014. Në mbledhjen e mbajtur deri në pasditen e vonshme, të ditë së djeshme, para anëtarëve të kuvendit, është prezantuar edhe raporti financiar nga ana Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, ndërsa në mesin e disa vendimeve, KK i Malishevës, i dha mbështetje edhe kërkesë së kryetarëve të

fshatrave për kthimin e shërbimeve nga regjioni Gjakovës në atë të Prizrenit.

Fillimisht, kryetari Begaj, përmes një raporti shumë voluminoz, ka prezantoi raportin e punës për vitin 2014, ku në mënyrë të detajuar janë paraqitur të gjitha punët e kryera nga ana qeverisë komunale, të cilën e drejton kryetari Ragip Begaj. Duke u bazuar në këtë raport, kryetari Begaj, tha “gjatë vitit 2014, kemi arritur, të menaxhojmë dhe shfrytëzojmë buxhetin, në shkallën 98 për qind, kemi arritur që të bëjmë investime, në të gjitha fshatrat e Komunës së Malishevës”. Pas diskutimit lidhur me raportin e punës, ku anëtarët e kuvendit, dhanë mendimet e tyre, lidhur me punën e qeverisë komunale, kryetari Begaj, tha: “Unë jam në shërbim të qytetarëve dhe jo në shërbim të partive politike. Nuk kemi qenë të përkryer, por kemi dhënë maksimumin e mundshëm”.

Më pas edhe drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Vesel Krasniqi, paraqiti raportin financiar për vitin 2014, me mënyrën e shpenzimit të buxhetit, të hyrat vetanake, dhe të gjitha këto, drejtori Krasniqi, i ka paraqitur edhe në formë vizuale.

Më pas Kuvendi i Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi z. Aziz Thaçi, ka shqyrtuar kërkesën kryetarëve të fshatrave, të datës 16.04.2015, për kthimin e të gjitha shërbimeve për nevojat e qytetarëve të Komunës së Malishevës, nga regjioni Gjakovës në regjionin e Prizrenit dhe unanimisht, KK i Malishevës, i ka dhënë mbështetje kësaj kërkesë.



Kuvendi i Komunës së Malishevës, dje mori vendim edhe për formimin dhe përbërjen e Këshillit Organizativ, për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimit të Malishevës.